



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. .... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 25 / 10 / 2023

**VENDIM**

Nr. 36 datë 25 / 10 / 2023

**PËR**

**STANDARTET TEKNIKE NË LIDHJE ME PRURJET KONTROLLUESE PËR SISTEMET E SHKARKIMIT TË DIGAVE TE MËDHA**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 25.10.2023 mori në shqyrtim Relacionin bashkelidhur këtij Vendimi në lidhje me Standartet Teknike për prurjet llogaritese dhe kontrolluese për sistemet e shkarkimit të digave të mëdha të përgatitur nga grupi i punës i caktuar në mbledhjen e KKDM të datës 30.08.2023 i përbërë nga ing. Arjan Jovani, ing. Dhimiter Vogli, ing. Andi Vila, ing. Ermal Kacurri dhe ing. Miriam Bogdani.

Në Relacionin e përgatitur nga grupi i punës janë dhënë problematikat e e derisotme në lidhje me prurjet llogaritese për sistemet e shkarkimit, eksperiencat në Europë dhe në bote, arsyet e përgatitjes së këtyre standartet si dhe domosdoshmerine e përgatitjes dhe miratimit të këtyre standarteve për procesin e kontrollit të sistemeve aktuale të shkarkimit në digat ekzistuese, projektimit të digave të reja dhe rritjen e sigurisë së digave të mëdha në vendin tonë. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

**VENDOSI:**

1- Kontrolli i sistemeve të shkarkimit në projektet e zbatimit të digave të mëdha të reja dhe në projektet e rehabilitimit të digave të mëdha ekzistuese të bëhet duke u bazuar në numrin e njerëzve të zonave urbane poshtë digës që ndodhen në rrezik për humbje jete si më poshtë:

Numri i njerëzve në rrezik për humbje jetësh	> 1000 njerëz	100-1000 njerëz	1-100 njerëz	Cdo dige që shkakton dëm ekonomik në zonën urbane poshtë digës
Siguria e prurjes për sistemet e shkarkimit	Prurja maksimale e mundshme (PMF)	1 herë në 10 000 vjet	1 herë në 1000 vjet	1 herë në 500 vjet

2- KKDM në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastruktura dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile pranë Ministrisë së Mbrojtjes të propozojë Këshillit të Ministrave miratimin e një Vendimi në lidhje me miratimin e standarteve teknike për përcaktimin e prurjeve llogaritese dhe kontrolluese të sistemeve të shkarkimit sipas tabelës së mësipërme si dhe shfuqizimin e Vendimit Nr. 68, datë 13.02.1989 në lidhje me klasifikimin e digave dhe përcaktimin e sigurisë së prurjes së shkarkimit për digat e ujtitjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

3- KKDM tu kërkoj të gjithë shfrytëzuesve të digave të mëdha me risk të lartë për humbjen e jetëve të njerëzve në zonat urbane poshte tyre të përgatitën dhe të përditesojnë hartat e përmbytjeve dhe Planet e Gadishmerisë për rastet e emergjencave civile për shkak të prurjeve maksimale apo prishjes së mundshme të ndonjë dige duke marrë për bazë sigurinë e prurjeve të dhëna në pikën e parë të këtij vendimi si dhe të instalojnë sistemet e Alarmit në digat e mëdha dhe në zonat urbane poshte tyre sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

4- Të gjitha projektet për ndërtimin e digave të reja si dhe projektet për rehabilitimin e digave ekzistuese që miratohen nga KKDM duhet të kenë llogaritjet përkatëse kontrolluese të kapaciteteve të sistemeve të shkarkimit sipas tabelës së mesiperme dhe duke u bazuar në matjet hidrologjike të 25 viteve të fundit.

5- Të gjitha projektet për ndërtimin e digave të reja si dhe projektet për rehabilitimin e digave ekzistuese që miratohen nga KKDM duhet të kenë llogaritjet përkatëse për përcaktimin e diferencës ndërmjet nivelit të kurores së digës dhe nivelit maksimal të ujit në rastet e prurjeve maksimale të llogaritura sipas tabelës së mesiperme. Në këto llogaritje duhet të përfshihen koeficientet e sigurisë minimale të digës (**ks**) që në çdo rast duhet të jetë jo më pak se 0.8 m, koeficienti i llogaritjes së vales **kv** në rezervuar si dhe koeficienti i llogaritjes së erës **ke** bazuar në të dhënat e matjeve përkatëse në zonën ku janë këto diga dhe rezervuare. Të gjithë shfrytëzuesit e digave të mëdha duhet të informojnë prapë KKDM çdo vit në lidhje me nivelet normale të operimit dhe niveleve maksimale të ujit gjatë prurjeve maksimale të ndodhura gjatë vitit duke ju referuar kuotes absolute të kurores së digës si dhe kuotes maksimale të lejuar sipas projektit.

6- Për rritjen e Sigurisë së digave të mëdha dhe për të shmangur problematikat në lidhje me qëndrueshmërinë e këtyre digave, KKDM tu kërkoj të gjithë shfrytëzuesve të digave që gjatë Operimit dhe shfrytëzimit normal të digave dhe rezervuareve, uljet e niveleve të ujit në rezervuar të kryhen me një intensitet ulje prej jo më shumë se 0.5 m në ditë.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këto vendime sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

**Arjan JOVANI**